



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

KËSHILLI DREJTUES

Nr. 96 Prot.

Data 27.10.2020

VENDIM

Nr. 11, datë 27.10.2020

PËR

“PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË TELEFONISË CELULARE NË
AUTORITETIN TË AVIACIONIT CIVIL”

Në zbatim të nenit 6, gërma “e” e Ligjit Nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar si dhe pikës 12 të VKM Nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Punonjësve të AAC, bazuar në funksionet që kryejnë, u ofrohet shërbimi i telefonisë celulare, sipas specifikimeve të mëposhtme:
 - Drejtor Ekzekutiv, deri në 10,000 lekë/muaj;
 - Drejtor Drejtorie si dhe këshilltar në kabinetin e titullarit dhe zëdhënës shtypi në kabinetin e titullarit, kategoria e pagës A, deri në 4,000 lekë/muaj;
 - Përgjegjës Sektori ose këshilltar në kabinetin e titullarit dhe zëdhënës shtypi në kabinetin e titullarit kategoria e pagës B, deri në 2,000 lekë/muaj;
 - Specialistët e Sektorit të Shërbimit të Lejeve të Fluturimit, për të përballuar shpenzimet e komunikimit me operatorët, në zbatim të detyrave funksionale, deri në 2,000 lekë/muaj.
2. Shërbimi i ofruar paguhet sipas faturës mujore për vlerën e shpenzuar. Tejkalimi i limitit mujor i përcaktuar, nuk kompensohet me limitin e muajit pasardhës dhe përballohet nga vetë punonjësi.